

VENDIM
Nr. 248, datë 30.3.2016

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK DHE PAKËSIMIN NË
VOLUM TË SIPËRFAQEVE QË DO TË PËRDOREN NGA SHOQËRIA TAP-AG PËR
SHTRIRJEN E TUBACIONIT TË GAZSJELLËSIT TAP, PËR SEKTORËT 4A, 4B DHE 5A,
NË QARQET KORÇË, BERAT DHE FIER**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, të ligjit 116/2013, “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), si dhe të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, në lidhje me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP)”, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave;

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore publike prej 11.557 (njëmbëdhjetë pikë pesëqind e pesëdhjetë e shtatë) ha, që do të përdoret nga shoqëria TAP AG për ndërtimin e seksionit tokësor të Gazsjellësit TAP, sektorët 4A, 4B dhe 5A, të hiqet nga fondi pyjor dhe kulloros publik, të pakësohet në volum dhe të çregjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave. Lidhja 1, me të dhënat për sipërfaqet pyjore që pakësohen në volum dhe hiqen nga fondi pyjor dhe kulloros publik, sipas qarqeve dhe bashkive, dhe harta topografike me gjurmën e ndërtimit të tubacionit i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat përkatëse të volumit të materialit drusor e të produkteve të tjera pyjore dhe të investimeve të kryera në vite, në pyjet, objekt i këtij vendimi, paguhet nga shoqëria TAP AG, para lidhjes së marrëveshjes me Ministrinë e Mjedisit, në bazë të lidhjes 4, të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria TAP AG detyrohet të rehabilitojë sipërfaqet që përdor, sipas kushteve të lejes mjedisore, dhe, brenda 2 (dy) viteve, të pyllëzojë, me fondet e veta, 11.094 (njëmbëdhjetë pikë nëntëdhjetë e katër) ha sipërfaqe me drurë pyjorë dhe të përmirësojë 2.544 (dy pikë pesëqind e dyzet e katër) ha kullota, në ngastrat e përcaktuara në marrëveshje me Ministrinë e Mjedisit.


4. Sipërfaqja pyjore dhe kullosore, sipas lidhjes 1 të këtij vendimi, mbetet pronë publike e shtetit dhe regjistrohet në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.



5. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të bëjë çregjistrimin e sipërfaqes pyjore dhe kullosore, të identifikuar sipas lidhjes 1 të këtij vendimi, nga kategoria “Tokë e zënë pyjore dhe kullosore” dhe ta regjistrojë në kategorinë “Tokë e zënë, objekt ndërtimi për segmentin tokësor të gazsjellësit TAP, seksioni 4A, 4B dhe 5A”.


6. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, nga shoqëria TAP AG, sipërfaqja pyjore dhe kullosore e rehabilituar të regjistrohet në fondin pyjor dhe kulloros publik.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Bashkia Korçë, Bashkia Poliçan, Bashkia Berat, Bashkia Ura Vajgurore, Bashkia Roskovec, Bashkia Fier dhe shoqëria TAP AG, zyra për Shqipërinë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.







LISTA E NGA STRAVE DHE NËN NGA STRAVE QË DO TË HIQEN NGA FONDI PYJOR
DHE KULLOSOR PUBLIK QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT TOKËSOR
TË TUBACIONIT TË GAZSJELLËSIT TAP , SEKSIONI 4A, 4B DHE 5A
NË QARQET KORÇË, BERAT DHE FIER

Lidhja 1

<i>ID Prones</i>	<i>Ekonomia Pyjore</i>	<i>Ngastra</i>	<i>Administrimi</i>	<i>Sip. qe preket nga gjurma (ha)</i>
KO66 02 030	Vidhkuq Lubonje	30	Ministria Mjedisit	0.4834
KO66 02 032	Vidhkuq Lubonje	32	Ministria Mjedisit	0.0731
KO66 01 063a	Vidhkuq Lubonje	63a	Ministria Mjedisit	0.0362
KO66 01 063b	Vidhkuq Lubonje	63b	Ministria Mjedisit	0.1242
KO66 01 064a	Vidhkuq Lubonje	64a	Ministria Mjedisit	0.154
KO66 01 064b	Vidhkuq Lubonje	64b	Ministria Mjedisit	0.1455
KO66 03 102a	Vidhkuq Lubonje	102a	NJQV	0.6248
KO66 03 030	Vidhkuq Lubonje	30	NJQV	0.0398
KO66 03 036	Vidhkuq Lubonje	36	NJQV	0.1759
KO66 03 043b	Vidhkuq Lubonje	43b	NJQV	0.0199
KO66 03 043d	Vidhkuq Lubonje	43d	NJQV	0.5296
KO66 03 050b	Vidhkuq Lubonje	50b	NJQV	0.0995
KO66 03 051a	Vidhkuq Lubonje	51a	NJQV	0.2062
KO66 03 051b	Vidhkuq Lubonje	51b	NJQV	0.0499
KO66 03 052a	Vidhkuq Lubonje	52a	NJQV	0.0376
KO66 03 052b	Vidhkuq Lubonje	52b	NJQV	0.055
KO66 03 060a	Vidhkuq Lubonje	60a	NJQV	0.2308
KO66 03 060c	Vidhkuq Lubonje	60c	NJQV	0.1172
KO66 03 061a	Vidhkuq Lubonje	61a	NJQV	0.1809
KO66 03 061b	Vidhkuq Lubonje	61b	NJQV	0.1623
KO66 03 061d	Vidhkuq Lubonje	61d	NJQV	0.0462
KO66 03 063a	Vidhkuq Lubonje	63a	NJQV	0.0647
KO66 03 067a	Vidhkuq Lubonje	67a	NJQV	0.1388
KO66 03 067c	Vidhkuq Lubonje	67c	NJQV	0.0584
KO66 03 067d	Vidhkuq Lubonje	67d	NJQV	0.1415
KO66 03 068a	Vidhkuq Lubonje	68a	NJQV	0.5152
KO66 03 068b	Vidhkuq Lubonje	68b	NJQV	0.2118
KO66 03 068c	Vidhkuq Lubonje	68c	NJQV	0.0915
KO66 03 070	Vidhkuq Lubonje	70	NJQV	0.2108
KO66 03 071a	Vidhkuq Lubonje	71a	NJQV	0.1958
KO66 03 096b	Vidhkuq Lubonje	96b	NJQV	0.0569
KO70 00 001	Zemlak Qarr	1	Ministria Mjedisit	0.3638
KO70 00 173	Zemlak Qarr	173	Ministria Mjedisit	0.5732
KO70 00 174	Zemlak Qarr	174	Ministria Mjedisit	0.6658
KO70 00 176	Zemlak Qarr	176	Ministria Mjedisit	0.2768
Totali Korce				7.157
BR23 00 056br1	Hija e Roshnikut	56b	NJQV	0.1334
BR23 00 056dr1	Hija e Roshnikut	56d	NJQV	0.4007

BR23 00 056cr1	Hija e Roshnikut	56c	NJQV	0.1617
BR18 00 145cr1	Bregu Balibardhes	145c	NJQV	0.0361
BR18 00 145ar1	Bregu Balibardhes	145a	Ministria Mjedisit	0.1501
BR23 00 010b1	Hija e Roshnikut	10b1	NJ.Q.V	0.320
BR23 00 010c1	Hija e Roshnikut	10c1	NJ.Q.V	0.0367
BR27 00 166br1	Mali Molishtit	166b	Ministria Mjedisit	0.1023
BR27 00 182br1	Mali Molishtit	182b	Ministria Mjedisit	0.5163
BR27 00 169ar1	Mali Molishtit	169a	Ministria Mjedisit	0.0446
BR27 00 181br1	Mali Molishtit	181b	Ministria Mjedisit	0.4534
BR27 00 182cr1	Mali Molishtit	182c	Ministria Mjedisit	0.1502
BR27 00 168br1	Mali Molishtit	168b	Ministria Mjedisit	0.4896
BR27 00 168ar1	Mali Molishtit	168a	Ministria Mjedisit	0.0248
BR27 00 180ar1	Mali Molishtit	180a	Ministria Mjedisit	0.286
BR27 00 179ar1	Mali Molishtit	179a	Ministria Mjedisit	0.0735
BR27 00 180cr1	Mali Molishtit	180c	Ministria Mjedisit	0.0302
BR16 00 001 r1	Ura e Kuçit-Mali-Kules-Mali Shpirag	1	Ministria Mjedisit	0.2538
BR16 00 016/1 r1	Ura e Kuçit-Mali-Kules-Mali Shpirag	16/1	Ministria Mjedisit	0.3519
	Totali Berat			4.0153
FR19014b	Lumi Seman 1	14b	Ministria Mjedisit	0.016
FR08007a	Br. Seman Dermenas	7a	Ministria Mjedisit	0.3508
FR19003a	Lumi Seman 2 Roskovec	3a	Ministria Mjedisit	0.018
	Totali Fier			0.3848
TOTALI				11.557